



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .12.2023

**MBLEDHJA Nr. 65,**  
**Datë 28.12.2023, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 28.12.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 65 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 26.12.2023.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin nëntor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 24, datë 23.03.2023.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Sang 1” shpk për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 20.12.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Arsti” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Arsti” me kapacitet të instaluar 3130 kW”.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s 265, datë 20.12.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Kalivar 1, 2, 3, 4”, i ndryshuar.
9. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sha në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë

10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sha në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” shpk për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
11. Mbi monitorimin e të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, në lidhje me mbajtjen e llogarive të ndara dhe strukturën aktuale organizative.
12. Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s.
13. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**